


Tregtia e jashtme e mallrave

Gusht 2023

Tiranë, më 18 Shtator 2023: Në Gusht 2023 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 mld lekë, duke u ulur me -21,9 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me -27,4 %, në krahasim me Korrik 2023. Importet e mallrave arritën vlerën 68 mld lekë, duke u ulur me -15,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe me -4,1 %, në krahasim me Korrik 2023. Deficiti tregtar i këtij muaji është 40 mld lekë, duke u ulur me -9,5 %, krahasuar me Gusht 2022 dhe duke u rritur me 22,9 %, në krahasim me Korrik 2023. Zhvlerësimi i Euros ka ndikuar në volumin tregtar, krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu, rënia e çmimeve në tregjet botërore të produkteve, që kanë impakt në volumin tregtar, ka ndikuar në treguesit e eksport/importit për muajin Gusht 2023 krahasuar me një vit më parë.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Në këtë tetëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 300 mld lekë, duke u ulur me -8,6 % krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 577 mld lekë, duke u ulur me -5,0 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 277 mld lekë, duke u ulur me -0,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Gusht 2023, në uljen e eksporteve prej -21,9 %, kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -14,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -3,8 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -1,3 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht ka ndikuar grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me +1,1 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Gusht 2023




Eksportet, gjatë këtij tetëmujori janë ulur me -8,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -7,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,7 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +1,7 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,4 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Gusht 2023, në uljen e importeve prej -15,0 %, krahasuar me Gusht 2022, negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -12,8 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -1,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,3 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht ka ndikuar grupi: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +3,7 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Gusht 2023



Si tetëmujor, importet janë ulur me 5,0 %, krahasuar me tetëmujorin e parë 2022. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,3 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me -0,6 pikë përqindje. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,1 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Gusht 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Gusht 2022 janë: Italia (15,5 %), Spanja (64,4 %) dhe Gjermania (42,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritje më të madhe, janë: Kosova (27,9 %) dhe Greqia (32,2 %).

Gjatë këtij tetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (11,0 %), Gjermania (28,3 %) dhe Kina (23,2 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kosova (10,0 %), Greqia (17,1 %) dhe Spanja (9,9 %).

Në muajin Gusht 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Turqia (40,1 %), Greqia (56,3 %) dhe Maqedonia e Veriut (19,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me Gusht 2022 janë: Italia (1,4 %), Kina (14,1 %) dhe Gjermania (14,5 %).

Gjatë këtij tetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (3,8 %), Turqia (21,1 %) dhe Greqia (22,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe janë: Kina (31,5 %), Gjermania (9,5 %) dhe Zvicra (78,0 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Gusht 2023



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 50,7 %, të gjithë tregtisë. Në Gusht 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 62,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 46,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (21,1 %), Kina (9,3 %), Greqia (6,7 %) dhe Gjermania (6,6 %).

Shkëmbimet tregtare, për tetëmujorin e parë 2023, me vendet e BE-së zënë 58,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Gusht 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,4 %), Kina (7,8 %), Turqia (6,8 %) dhe Greqia (6,7 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Gusht 2023

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	08 - 20	19	-3,4	48	-6,7	-29	40,2
	Janar – Gusht 20	169	-15,4	376	-12,3	-207	45,0
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	07 - 21	32	30,6	72	26,1	-39	44,8
	08 - 21	24	22,5	61	26,2	-37	39,0
	Janar – Gusht 21	232	37,3	487	29,3	-254	47,8
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	08 - 22	35	48,1	80	30,8	-44	44,2
	Janar– Gusht 22	328	41,0	607	24,8	-280	54,0
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	Janar– Gusht 23	300	-8,6	577	-5,0	-277	51,9

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Gusht 2023

	Eksporte				Importe			
	Gusht 2022	Gusht 2023	Jan, - Gusht 2022	Jan, - Gusht 2023	Gusht 2022	Gusht 2023	Jan, - Gusht 2022	Jan, - Gusht 2023
Vendet e BE-së	23.548	17.081	239.864	217.991	37.672	31.169	318.022	294.922
Austri	667	329	3.541	2.686	691	391	4.579	4.798
Gjermani	2.164	1.256	22.399	16.066	4.351	4.983	36.948	40.456
Greqi	1.849	2.406	17.902	20.964	9.007	3.932	48.908	37.887
Itali	10.268	8.676	144.283	128.439	11.206	11.367	134.122	128.960
Spanjë	4.833	1.721	12.306	13.521	1.503	1.763	10.262	9.384
Kroaci	494	202	5.252	3.581	1.263	947	6.531	5.286
Të tjera të BE-së	3.274	2.491	34.181	32.733	9.651	7.786	76.672	68.152
Mbretëri e Bashkuar	139	2.458	1.420	5.884	682	570	5.116	5.420
Kinë	153	813	7.440	5.715	7.003	7.990	47.595	62.585
Kosovë	2.925	3.740	25.010	27.520	1.406	1.116	10.476	7.514
Maqedonia e Veriut	1.101	1.051	11.161	12.248	1.577	1.274	10.262	9.107
Rusi	13	-	25	8	1.051	345	7.376	3.170
SHBA	4.650	457	10.666	2.956	2.012	1.117	9.116	11.462
Turqi	544	196	4.241	2.650	9.712	5.820	71.881	56.698
Ukrainë	53	5	411	1.025	497	232	2.841	2.681
Zvicër	124	112	2.465	3.652	556	920	5.102	9.079
Të tjera	1.939	1.581	25.008	20.008	17.401	17.114	119.483	114.301
Gjithsej	35.188	27.494	327.711	299.657	79.568	67.668	607.269	576.940

Tab.3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Gusht 2023

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Gusht 2022	Gusht 2023	Jan, - Gusht 2022	Jan, - Gusht 2023	Gusht 2022	Gusht 2023	Jan, - Gusht 2022	Jan, - Gusht 2023
Gjithsej	35.188	27.494	327.711	299.657	79.568	67.668	607.269	576.940
Ushqime. pije. duhan	3.378	3.050	32.725	38.443	13.814	13.214	99.360	95.686
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	8.990	8.697	72.587	69.315	20.266	10.102	103.153	67.678
Produkte kimike dhe plastike	882	1.261	12.624	10.367	9.230	8.098	77.120	76.614
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	171	115	1.904	1.867	873	592	11.418	9.480
Prodhime druri dhe letre	1.120	659	9.224	7.507	2.662	2.227	23.153	19.888
Tekstile dhe këpucë	7.175	5.843	87.743	85.386	6.128	5.122	64.948	61.433
Materiale ndërtimi dhe metale	9.873	4.851	77.669	52.100	9.835	8.894	88.923	81.232
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	2.692	2.306	25.095	26.511	13.825	16.758	116.803	141.451
Të tjera	907	712	8.138	8.161	2.934	2.661	22.390	23.478

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Gusht 2023

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Gjithsej	144.283	128.439	25.010	27.520	17.902	20.964	22.399	16.066
Ushqim. pije duhan	7.232	10.219	3.715	4.568	2.581	3.141	1.061	1.298
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	17.218	6.456	3.656	5.426	2.761	7.570	12.822	5.887
Produkte kimike dhe plastike	3.115	3.926	2.790	2.731	2.858	722	43	37
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.732	1.752	10	7	29	22	9	9
Prodhime druri dhe letre	5.568	4.374	986	814	1.369	1.188	232	76
Tekstile dhe këpucë	68.658	66.530	120	157	3.816	4.733	5.395	6.439
Materiale ndërtimi dhe metale	23.923	17.386	11.458	11.100	3.849	2.827	816	904
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	12.995	14.171	1.260	1.577	102	86	1.705	1.177
Të tjera	3.840	3.625	1014.9	1.139	538	675	317	239

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Gusht 2023

	Itali		Kinë		Turqi		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Gjithsej	134.122	128.960	47.595	62.585	71.881	56.698	36.948	40.456
Ushqim. pije duhan	18.696	18.712	977	1.259	4.291	4.002	3.871	3.892
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	3.284	4.533	5	28	4.843	7.458	606	653
Produkte kimike dhe plastike	16.741	15.659	4.854	5.390	8.071	8.000	8.578	7.727
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	8.975	7.621	636	595	364	224	33	75
Prodhime druri dhe letre	4.951	4.429	769	1.333	3.838	3.132	837	607
Tekstile dhe këpucë	32.194	28.469	7.465	8.262	12.137	9.381	1.411	1.732
Materiale ndërtimi dhe metale	17.444	17.053	5.702	8.895	26.713	13.239	1.235	1.322
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	26.700	26.892	22.525	32.180	8.069	8.559	19.052	22.965
Të tjera	5.138	5.592	4.662	4.642	3.555	2.704	1.325	1.482

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri